

UNDEF

The United Nations
Democracy Fund



FNUD

Fonds des Nations Unies
pour la démocratie



**Raport mbi realizimin e
premtimeve elektorale të
z. Ndrec Dedaj, Kryetari i
Bashkisë Mirditë**

PROJEKTI

**“Ndjekja dhe verifikimi i
premtimeve të fushatës
zgjedhore në Shqipëri”**

Mbështetur nga:

**Fondi për Demokraci i Kombeve të
Bashkuara**

Për më tepër informacion vizitoni platformën online “Matësi Elektorale” (The Albanian Truth-o-Meter Platform):

www.matesielektor.al

Ju mirëpresim të kontribuoni me ide dhe sugjerime mbi shpenzimet/investimet buxhetore lokale apo të qeverisjes qendrore si dhe mbi premtimet elektorale të realizuara ose të parealizuara të të zgjedhurve lokalë dhe anëtarëve të qeverisë.

E-mail: rdakorca@gmail.com

Tel: + (355) 822 42626

Premtimet elektorale të z. Ndreç Dedaj, Kryetari i Bashkisë Mirditë

1. Rilindje urbane për Bashkinë e Mirditës;
2. Sistem i ri për grumbullimin e mbetjeve urbane;
3. Hartimi i nje plani mbi turizmin kulturor dhe për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;
4. Strehimi i një kategorie njerëzish që jetojnë në geto, në rrethinat e qytetit;
5. Të gjitha rrugët që shkojnë në qendrat e fshatrave do të jenë të aksesueshme nga automjetet e vogla;
6. Do të asfaltohen në parametra bashkëkohorë rrugët: Rrëshen – Kurbnesh me drejtim Lurën, Rrëshen – Kaçinar, Rrëshen – Malaj dhe Rubik – Velë;
7. Do të ndërtohet rruga që lidh qytetin Rrëshen me autostradën;
8. Sigurimi i ujit të pijshëm dhe për vaditje në çdo familje apo qendër lagjeje;
9. Evidentimi i resurseve që ka territori dhe konvertimi i tyre ligjor në të ardhura për zhvillimin e zonës;
10. Sigurimi i transportit urban;
11. Pastrimi i kanaleve kulluese dhe vaditëse;
12. Bashkëpunim permanent me grupet e interesit dhe organizim i vazhdueshëm i dëgjësave publike.
13. Për turizmin dhe trashëgiminë kulturore, konkretisht:
 - a. Krijimi i hartës turistike për Mirditën;
 - b. Shtimi i monumenteve të trashëgimisë historike, kulturore dhe natyrore për t'i përfshirë në databazën e Ministrisë së Kulturës;
 - c. Prodhimi i doracakut turistik për Mirditën (shqip-anglisht);
 - d. Vendosja e sinjalistikës turistike në për të gjitha vendet me monumente historike apo natyrore;
 - e. Ndërhyrja në kullat monument sinë Rubik, Selitë, Përlat, Orosh, Fan, Kaçinar, etj;
 - f. Qarkullimi i “MirditësTuristike”si aktivitet i përvitshëm në çdo zonë të Mirditës;
 - g. Harta dixhitale e turizmit të zejeve dhe artizanatit, bartës vetë folkut, etj;
 - h. Krijimi i destinacioneve turistike, duke aplikuar projekte konkrete si për Udhën e Madhe (Vau i Dejës-Vig-Ungrej-Bukmirë-Simon-Shpal-Orosh-Nënshejt-Xhuxhë e më tej), por dhe zona të tjera;
 - i. Do t'i jepet rëndësi turizmit speleologjik (turizmit të shpellave) duke listuar dhe kujdesur për to;
 - j. Nxitja e krijimit të agjencive turistike të munguara në Mirditë.

Burimi: <http://pushtetivendor.reporter.al/ndrec-dedaj-vizioni-im-per-mirditen/>

Premtimet e arritura

1. Rikonstruksioni i rrugës që lidh lagjen Kolsh me qytetin e Rrëshenit.
2. Hapja e segmentit rrugor që mundëson kalimin e mjeteve në majën e Trangës, një pikë turistike jashtëzakonisht e dëgjuar, por që ishte prej vitesh e izoluar.
3. Rikonstruksioni i pallatit të sportit “Arjana Arapi” në Rrëshen.

4. Rrjetëzimi i rrjetit vaditës në fshatin Kodër – Rrëshen.
5. Rehabilitimi rrënjësor dhe finalizimi i rrjetit shpërndarës të furnizimit me ujë të pijshëm në qytetin e Rrëshenit i cili do të furnizojë qytetarët me ujë 24 orë.
6. Kopsht i ri për fëmijët në qytetin e Rrëshenit.
7. Ndërtimi i unazës së madhe që nis nga kthesa e ish-shkollës së lirë ushtarake dhe lidhet me unazën e vogël të qytetit.
8. Rikonstruksioni rrënjësor i shkollës “Pashko Vasa” në qytetin e Rrëshenit.
9. Ndërtimi i një banese të re në fshatin Bulshar të Njësisë Administrative Orosh, për një familje në nevojë. Kjo ndërhyrje është në kuadër të nismës së kryetarit të Bashkisë për ndërtimin e 50 banesave në Mirditë për familjet me kushte të vështira.
10. Rehabilitimi i ujëmbledhësit në Malaj, duke përdorur një teknologji të re gjermane e cila aplikohet për herë të parë në Shqipëri.
11. U realizua shtegu i parë i markuar për ecje në këmbë, në Mirditë. 7 km hiking nëpër arealin turistik dhe trashëgimor në zonën e Rubikut, i markuar me sinjalistikën më të avancuar dhe standarte të larta europiane.
12. Rikonstruksioni i unazës së qytetit të Rrëshenit.
13. Riparimi i kullës në rezervuarin vaditës në Sheshaj, Njësia Administrative Rrëshen.
14. Rehabilitimi i nënstacionit elektrik të Rubikut. Një investim i cili rrit kapacitetet e këtij nënstacioni si dhe përmirëson cilësinë e furnizimit me energji elektrike për banorët e zonës që mbulon.
15. Rehabilitimi i shkollës "Ndrec Ndue Gjoka", në Njësinë Administrative Fan.

Burimi: <https://www.facebook.com/mirditebashkia>